



## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 14 paragrafi 7 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja; dhe
- Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_542\_2013 i datës 28 qershor 2013 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Era, në Lokacionin "Wind Park – Budakova", me kapacitet të instaluar prej 30 MW, komuna e Suharekës & Ferizajt & Shtërpçës, të datës 06.06.2015, të shoqërisë "Upwind International II GmbH - Dega në Kosovë", me adresë rruga "UÇK" nr. 48/2, Kati I, Banesa nr. 2, Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 16 korrik 2015 nxori këtë:

## V E N D I M

- I. **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_542\_2013 i datës 28 qershor 2013, edhe për një afat gjashtë (6) muaj, gjegjësisht **deri me 28 dhjetor 2015**.

## A r s y e t i m

- o ZRRE, me datë 13.02.2013 nga shoqëria "Upwind International II GmbH – Dega në Kosovë", ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Era, në Lokacionin "Wind Park – Budakova", me kapacitet të instaluar prej 30 MW, komuna e Suharekës & Ferizajt & Shtërpçës.
- o ZRRE pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji, me datë 28 qershor 2013 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_542\_2013, dhe ka udhëzuar aplikuesin që t'i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- o Vendim mbi njoftimin për autorizimin preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- o Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, është lëshuar në afat (2) dy vjeçar, dhe në këtë vendim është përcaktuar se shoqëria "Upwind International II GmbH – Dega në Kosovë", do t'i jepet Autorizimi për ndërtim, nëse brenda këtij afati do të bëjë një kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
- o ZRRE me datë 06.06.2015 nga shoqëria "Upwind International II GmbH – Dega në Kosovë", ka pranuar Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për



Autorizimin Preliminar për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Era, në Lokacionin "Wind Park – Budakova", me kapacitet të instaluar prej 30 MW, komuna e Suharekës & Ferizajt & Shtërpcës, edhe për një afat shtesë sipas legjislacionit në fuqi.

- Shoqëria "Upwind International II GmbH – Dega në Kosovë", në kërkesën e saj ka sqaruar se: jemi në proces të finalizimit dhe arritjes së marrëveshjes me investitorët për projektin në fjalë, e cila pritet të finalizohet së shpejti, pasi që po kërkon shumë precizitet dhe siguri. Gjithashtu ka sqaruar se janë në përfundim e sipër të sqarimeve teknike ( matjeve gjeologjike të tokës, përgatitjes së dokumentacionit për aplikim për leje të ndërtimit), pika të cilat janë specifike dhe kërkojnë impute nga institucionet përkatëse për realizimin final të projektit. Poashtu kanë theksuar se janë në negociata me Ministrinë e Financave dhe Administratën Tatimore të Kosovës, për gjetjen e lehtësirave doganore dhe lirimeve nga tatimet.
- ZRRE pas analizimit të kërkesës për shlyerje të afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, ka vlerësuar ato dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

V. Shoqëria "Upwind International II GmbH – Dega në Kosovë", duhet të bëjë kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Era, në Lokacionin "Wind Park – Budakova", me kapacitet të instaluar prej 30 MW, komuna e Suharekës & Ferizajt & Shtërpcës, deri me datën **28 dhjetor 2015** duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.


VI. Pas skadimit të afatit të cekur më lartë, Vendimi V-542-2013 i datës 28 qershor 2013 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, do të shfuqizohet në mënyrë automatike, dhe nuk do të shqyrtohet nga Bordi i ZRRE-së.


VII. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.


VIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së**

  
Envër Halimi, kryesues

  
Merita Kostari, anëtare

  
Krenar Bujupi, anëtar